



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN DHE INVESTIMEVE TË HUAJA

Nr. 13134/7 Prot

Vlorë, më: 30. 10 2023

PROCESVERBAL KONSULTIM PUBLIK

RAJONI 2

**Datë: 17.10.2023 Ora: 16:30**

**Tema: Konsultimi i Buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2024 për Bashkinë Vlorë**

**Baza Ligjore:** Në zbatim të ligjit nr.139/2015 “Për vetqeverisjen vendore” neni 18; ligjit nr.119/2014 “Për të drejtën e informimit”, ligjit nr.146/2012 “Për njcftimin dhe konsultimin publik” pika 1 dhe 2 neni 5, pika 1,2,3,4 neni 52; Rregullores e Organizimit dhe Funkcionimit të Bashkisë; si dhe Urdhrit nr.11769 datë 4.10.2023.

**Marrin pjesë:**

*Kryetari i Bashkisë Vlorë-z. Ermal Dredha; Kryetar i Rajonit 2- Orest Ruci; nenkryetarët e bashkisë; Daut Zeraj-Sekretar i Këshillit Bashkiak,, Drejtori i buxhetit dhe finances-Hiqmet Haxhaj, drejtorë të Administratës së Bashkisë Vlorë, anëtarë të këshillit bashkiak, përfaqësues nga komuniteti, përfaqësues nga biznese, Media dhe OJF,*

*(Në takim morrën pjesë mbi 42 persona, listëprezenca bashkangjitur)*

**Takimin e hapi Ermal Dredha: Kryetar i Bashkisë Vlorë-** Përshëndetje dhe faleminderit. Po vazhdojmë procesin e konsultimeve për projektbuxhetin e bashkisë dhe ky është takimi i parafundit. Qëllimi është të shikojmë propozimet tuaja për projektbuxhetin e vitit 2024. Praktika që është ndjekur është që prezanton drejtori i financës për buxhetin afatmesëm dhe planifikimin për vitin 2024. Jemi orientuar sipas prioriteteve që ka plani.





## Konsultimi i Buxhetit afatmesëm 2024-2026 dhe planifikimi për projektbuxhetin e vitit 2024

Për më shumë konsultoni linkun

<https://fb.watch/nN1fyPh5-5/?mibextid=v7YzmG>

**Hiqmet Haxhiaj-Drejtor DFBK-** Vijnë me dëgjese për hartimin e buxhetit 2024. Treguesit bazë për buxhetin afatmesëm 2024-2026.

Për vitin 2024 të ardhurat total-2.659.506 (2 miliard ...lek)

Nga të ardhurat e veta – 1.501.312 mijë lekë (1 miliard 501 milion 312 mijë lekë)

Në projekt buxhet janë planifikuar investimet 377,748 mijë.

Investimet për vitin 2024 për Rajonin 2.

- Rikonstrukcion i Kopshtit të Lagjes së Ujit të Ftohtë
- Investim në sistemin e ujrave të ndotura përgjatë Lungomares.
- Sistemi i parkimit publik përgjatë Lungomares

Gjithashtu do të investohet në rrugë, lulishte, ndricim dhe rregullime në lagjet e brendshme.

**Ermal Dredha:** Sot nuk është present drejtori i urbanistikës, për arsye familjare. Po jua paraqes unë prezantimin e tij.

Kemi dakortësim me Fondin e Zhvillimit për asfaltimin përgjatë Lungomares

Do të bëhet rikonstrukcion në palestrën “Flamurtari,” të qytetit, Pjesë e zonës së ish Fabrikës së Cimentos.

Investimi te projekti i Fabrikës së Cimentos shkon në vlerën 300 milion

Projekti i Lulishtes te Kali i Trojës. Ka patur probleme me pronësinë, do jua sjellim të rregulluar lulishten.

Rruga te shkolla “Ismail Qemali” do të asfaltohet




Gjithashtu dhe rruga që të con në shkollën Tregtare do investohet në trotuare dhe ndricim, do ta bëjme most ë jemi të cunguar. Për investime të vogla do të jemi fleksibël.

Pres sygjerimet dhe kërkesat tuaja.

**Banor:** Rruga te Hanoveri, na vjen përroi, s'ka asnjë shërbim, është e ndotur dhe vin era kur kalon. Të asfaltohet, të vendosen kosha. Kanali ka bllokuar rrugën. Tubacioni i Lungomares. Te ura është e bllokuar totalisht rruga. Kemi shumë probleme dhe skemi patur asnjë shërbim. Ujrat e zeza...1700 veta kemi firmosur. Lavazhot problem gjithashtu. Të marrim shërbimin që na takon.

**Banor** – Lagja 10 korriku. Firma bëri punime dhe ka lënë 40m rrugë të rpushur e cila është vetëm baltë.



**Banor:** Kemi probleme sociale. Kasollja ku banoj përmytet me ujë. Inxhinieri e ka parë 3 herë. Rajoni të ri hapur të na dëgjoj e të na presi. Kush do ma zgjidhi problemin. Jo kanali po rruga nuk mirëkuptohemi më njëri tjetrin. Rruga që bërë nga psikiatria te Lungomare dhe ikin të gjithë me shpejtësi, të vihen tabela për kufizimin e shpejtësisë.

**Ermal Dredha:** “Policet e shtrire” do i parashikojmë, edhe sinjalistikën po ashtu për orientim në rrugë. Kemi bashkëpunimin dhe konsulencën e Bankës Botërore për të bërë një scan të qytetit së bashku me inxhinierët. Projekti do bëhet.

**Kreshnik Tepelena:** Banor; rruga Konomi, kemi problem ujrat e zeza.

Parkimi në një krah, gjithahtu parkimi public që u ndërtua, shumë mirë që është me pagesë por të ardhurat duhet ti venë bashkisë.

Sport- më shumë aktivitete sportive.

**Banor:** Rruga mbi Miramare ka mangësi të koshave dhe ndricim.

**Ermal Dredha:** është detyrë funksionale e bashkisë. Ka mangësi të koshave dhe kemi filluar blerjen.



**Banor:** Rruga mbi Shikun është e pashtuar. Ska ndricim dhe ska kosha. I mbani shënim dhe na njoftoni zgjidhje.

**Banor/Biznes;** Mbas shkollës Ismail Qemali, rruga u shtrua por s'ka ndricim.

**Pyetje/Pyetje:** Kam 2 sygjerime: Në rrugën Vlorë –Skelë, janë pengesë autobusat dhe stacionet. Të spostohet stacioni te rotondo dhe të vendoset pas kthesës. Po kështu dhe stacioni te tregu I orizit, në mënyrë që të lirohet rruga që të con në Kaninë.

**Pyetje/Pyetje:** Të gjejmë një zgjidhje në funksion të qytetit që të rinjtë mos të ikin jashtë por të zgjedhin Vlorën për të ndërtuar jetën! Turizmi të jetë gjithë vjetor.

**Ermal Dredha:** Nuk ka lidhje me projektbuxhetin. Qeveria po bën investime të mëdhaja në Vlorë, si Aeroporti dhe Marina. Por përfitues jemi ne. Do kemi shumë shance për vende punetë reja, mundësi zhvillimi, linja prodhimi.

**Pyetje/Pyetje:** Për Rajonin 2, te Rinia, Bar “Ini”lulishtja që u rregullua i jep pamje dhe i shërben qytetarëve. Investimet duan kohë dhe bashkëpunim.

**Arben Meksi:** Ju falenderoj që mbajtet premtimin në fushatë dhe mbledhjet në takim në bashki, specialistët, sepse Vlorë ka shumë, inxhinier, arkitekt, urbanist. Fryma juaj për ti vlerësuar është e mirë. Aty u diskutua për projekte. E di sa fonde ka buxheti i Vlorës dhe sa investon qeveria, sepse kam qënë anëtar i këshillit bashkiak. Ne do na keni mbështetje. Jeni prmetues. Ka filluar të punohet në sektorin e pastrimit dhe po e shikojmë cdo ditë ndryshimin në qytet. Problemet e mëdha si trafiku do vazhdojnë të shtohen turistët pas investimit në projektin e aeroportit dhe marinës. Do shtohet fluksi i turizmit. Parkimet e rrugës duhet të gjendet zgjidhje. Coni një projekt ide për të ndërtuar parkim nëntokësor e mbitokësor me kapacitet mbajtës të madh në 3 nyjet më të nxehta të qytetit, Rrapi, Tyneli, Kalaja. Gjithashtu duhen mjete të tjera publike për të shfryrë trafikun në qytet. Me buxhetin e bashkisë këto nuk bëhen. Liberalizoni lejet e ndërtimit, ju hapni rrugën lejeve dhe lekët që do mblidhen shtojnë të ardhurat në buxhetin e bashkisë. Te rruga e Shkollës Tregtare ka nevojë për ndricim. Të alokohet një fond për skulpturat sepse në rajon ka vende ku mund të vendosen. Faleminderit!

**Banor:** janë problem shumë I madh kanalet e ujrave të zeza përgjatë Lungomares deri në Ujë të Ftohtë. Të shtohen pusetat në pikat e nxehta. Të pastrohen tubot. Derdhjet të kenë sistem kullimi për në plazh.

**Ermal Dredha:** Menaxhimi i ujrave të zeza është angazhim dhe përfshirje e investitorëve përgjatë Lungomares. Kreministri përmendi dhe përfshirjen. Të kemi gjithashtu një angazhim të përbashkët sepse ndotësit më të mëdhenj janë bizneset dhe restorantet, mbetjet derdhen në det. Do rëndohen xhepat e atyre që kanë hotelet. Kur të bëhet kjo zyrtare, do bëhet VKB. Do bëjmë një fushatë për investitorët në Lungomare.



**Sokol Kanani-Banor:** Restaurimi i lagjes Avni Rustemi, kanali nga fabrika e tullave, në rrugën central dhe dalje në lungomare. Zona po merr zhvillim të madh. Të shmangët derdhja e ujrave të zeza në det.

**Ermal Dredha:** Ju falenderoj për kohën dhe bashkëpunimin! Jam në dispozicionin tuaj së bashku me administratën.

**Ermal Dredha:** Faleminderit!



**Konceptoi: Albana Naçi**  
**Koordinatorë për Njoftimin dhe Konsultimin Publik**